



Бр./ Nr./ No. 04-

Скопје, Shkup, Skopje

.2023 година/viti/year

Në bazë të nenit 52 të Ligjit për nëpunësit administrativ ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 275/19, 14/20, 215/21 dhe 99/22), Procesverbali nga puna e Komisionit për përzgjedhjen për avancim të nëpunësit administrativ pas kryerjes së intervistimit numër 04-8/16 datë 31.03.2023, si dhe Njoftimin e Ministrisë së Financave me numër arkivi 18-3833/2 datë 10.03.2023, Sekretari i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik solli:

V E N D I M

Për zgjedhjen e kandidatit nëpërmjet Shpalljes së brendshme numër 01/2023 për avancimin e 1 (një) nëpunësi administrativ

1. Kandidati **Petar Gajdov** zgjidhet ekzekutues i pozitës Këshilltar Shtetëror për bashkëpunim me posedues të informacioneve, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe projekteve, me titullin Këshilltar Shtetëror.
2. Vendimi për avancim për kandidatin e emëruar do të sillet në afat prej pesë ditësh nga përfundimi i këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit.

A R S Y E T I M

Më 17 mars 2023, në faqen e Agjencisë për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik dhe në ueb faqen e Agjencisë për administratë është publikuar Shpallja e brendshme Nr. 01/2023 për avancimin e 1 (një) nëpunësi administrativ.

Me Vendimin Nr. 04-8/14, datë 22.03.2023, u krijua Komisioni Përzgjedhës për Avancim, i cili kreu procedurën e avancimit. Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes, Komisioni përpiloi Procesverbalin e përzgjedhjes administrative për shpalljen e brendshme nr. 04-8/15, datë 31.03.2023, Procesverbal i punës së Komisionit Përzgjedhës për ngritjen në detyrë të nëpunësit administrativ me qëllim të intervistimit Nr. 04-8/16 të datës 31.03.2023 dhe pas intervistës së kryer nga Sekretari i Përgjithshëm, Komisioni ka përgatitur renditjen përfundimtare të kandidatëve të intervistuar dhe propozim vendimin për përzgjedhjen e kandidatit të renditur të parë Petar Gajdov me gjithsej 37,35 pikë për postin Këshilltar Shtetëror për Bashkëpunim me poseduesit e informacioneve, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe projektet.

Duke marrë parasysh sa më sipër, Sekretari i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik, ka miratuar këtë Vendim.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi kandidati i pakënaqur ka të drejtë të paraqesë ankesë në Agjencinë për Administratë - Komisioni për vendimmarrje për ankesat dhe kundërshtimet e nëpunësve administrativ të shkallës së dytë në afat prej tetë ditësh nga dita e publikimit.

Sekretar i përgjithshëm,

M-r Tanja Kovaçev

Dorëzuar deri tek:

- I emëruari dhe
- Arkivi.

Përpunoi: Vasillka Pop Gjeorgjieva

Përktheu: M-r Valon Mustafa